



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:293097

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05336993

C.nr.1902/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me procesmbajtës – praktikant i kësaj Gjykate Lorent Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve A. M., B.T. B. I., G. I. dhe M. H., të gjithë nga M., të cilët i përfaqëson avokat Leotrim Ademi, me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. Arbnor Murturi me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: “*Kompensim i shujtës ushqimore*”, jashtë seance më datë 15.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
(Në bazë të pohimit)

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: A. M., B.T. B. I., G. I. dhe M. H., të gjithë nga M., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit të shujtës ushqimore, ti kompensoj si vijon:
1. Paditësit A. M, në emër të kompensimit të shujtës ushqimore për periudhën kohore 21.01.2021 deri 22.11.2022, për 367 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 734 €;
 2. Paditëses B.T, në emër të kompensimit të shujtës ushqimore për periudhën kohore 21.01.2021 deri 22.11.2022, për 264 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 528 €;
 3. Paditësi B. I., në emër të kompensimit të shujtës ushqimore për periudhën kohore 21.01.2021 deri 22.11.2022, për 358 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 716 €;
 4. Paditësi G. I., në emër të kompensimit të shujtës ushqimore për periudhën kohore 21.01.2021 deri 22.11.2022, për 202 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 404 €;
 5. Paditëses M. H, në emër të kompensimit të shujtës ushqimore për periudhën kohore 21.01.2021 deri 22.11.2022, për 367 ditë punë, t’ia paguaj shumën prej 734 €;

Secilit paditës veç e veç me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë (14.12.2023) e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. APROVOHET PJESERISHT SI BAZUAR kërkesa e paditëseve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësve tua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 353.00 €, të gjitha këto ti përmbush në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PA BAZUAR përtej pjesës së aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, me të cilën kanë kërkuar në emër të precizimit të kërkesëpadisë t'ua paguaj e paditura shumën prej 312,00 €.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate, me datë 14.12.2023, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti për kompensim e shujtës ushqimore, për ditët e pranisë në punë. Tutje i njëjti ka theksuar se paditësve nuk i'u është bërë kompensimi për shujtën ushqimore edhe pse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, i njëjti me anë të parashtrësës së datës 14.12.2023 ka precizuar kërkesë padinë në kuptim objektiv dhe ka kërkuar kompensimin e shujtës ushqimore për paditësit për periudhën kohore prej 21.01.2021 deri 22.11.2022, dhe atë për paditësin A. M., shumën prej 734 €, për paditësen B. T., shumën prej 528 €, për paditësin B. I., shumën prej 716 €, për paditësin G. I., shumën prej 404 €, si dhe për paditësen M. H., shumën prej 734 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 14.12.2023, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 €, për precizimin e kërkesë padisë (parashtrësë) shumën prej 312.00 €, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 41.00 €.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprakë të padisë ka nxjerr aktvendim për përgjigje ne padi C.nr.1902/23 të datës 02.02.2024, duke e paralajmëruar edhe me pasojat procedurale se nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes.

E paditura në përgjigjen në padi të paraqitur me datën 13.02.2024 ka theksuar se meqenëse paditësit kanë bashkangjitur prova me anë të së cilave vërtetojnë ditët e pranisë në punë për periudhën kohore gjatë së cilës e kanë kërkuar kompensimin për shujta e pohon. Gjithashtu e njëjta e ka kundërshtuar kërkesën e paditësit për kompensimin e shpenzimeve të procedurës sa i

përket shumës prej 312.00 euro për përpilimin e precizimit të padisë pasi që kjo nuk parashihet me nenin 6 të rregullorës së OAK –së.

Gjykata pas pohimit të padisë dhe kërkesëpadisë së paditëseve nga ana e të paditurës me përgjigje në padi të dhënë me datë 13.02.2024 konstaton se kërkesa është e disponueshme për palët dhe se e njëjta nuk është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 3 të LPK –së.

Prandaj gjykata në kuptim të nenit 148 par. 1 të LPK –së me të cilin përcaktohet se: ” *Në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykim me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim në bazë të pohimit)*” dhe gjykata vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, e në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë datë 14.12.2023.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, në kuptim të nenit 452 të LPK-së, ashtu që detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë në lartësi prej 312.00€ - sipas tarifës së OAK - së, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 41.00€.

Ndërsa pjesën tjetër ka refuzuar pjesërisht si në pikën III të dispozitivit lidhur me shpenzimet sa i përket precizimit të kërkesëpadisë në shumë prej 312.00 €, pasi që precizimi i të njëjtës konsiderohet petitumi i padisë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1902/23, datë 15.02.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.